

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Ligjet" miratojnë pr/ligjin e PS për pagat e magjistratëve, gjykatësit e prokurorët paralajmërojnë dërgimin në Kushtetuese
ADRESA	https://versus.al/politike/ligjet-miratojne-pr-ligjin-e-ps-per-pagat-e-magjistrateve-gjy-katesit-e--i46602
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 16:03:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	784acb22535ed6b3dd6c107661c44863c3532598983101d1fa34644ba573c55d
TEKSTI	cf339f0d2429a825bdba6bddef4a43530038be9e551761665b364a45f42fd8
PAMJA	8fc7e04e16bffeaa71afabafb1e61df30b5cf0b0bdac0567dbb93afffda13f8c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	622d282a3e4647c31ee9c47b2e83f09b640d05ec193424b315270f626f9fca75
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/622d282a3e4647c31ee9c47b2e83f09b640d05ec193424b315270f626f9fca75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



AKTUALITET

[Kokaina e fshehur tek pulat e AMG Food, e grupit të Gert "gjeneralit"? Belgët zbardhin enigmën e 37 pakove të kapura në Portin e Durrësit](#)

15 Shtator 2026, 16:35

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[POLITIKË](#) / 15 Shtator 2026, 17:50

"Ligjet" miratojnë pr/ligjin e PS për pagat e magjistratëve, gjykatësit e prokurorët paralajmërojnë dërgimin në Kushtetuese

Përplasja për pagat në sistemin e drejtësisë nisi pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik formulën e re të pagave, në përputhje me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese.





Komisioni i Ligjeve miratoi nen për nen ndryshimet ligjore për rritjen e pagave të magjistratëve. Miratimi i draftit i hap rrugë shqyrtimit dhe votimit të tij të enjten në seancë plenare.

Me kërkesë të Partisë Demokratike dhe me dakordësinë e mazhorancës, në komision u thirrën për t'u dëgjuar përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, të cilët kundërshtuan formulën e propozuar nga qeveria.

Në emër të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, kryetarja Mirela Bogdani u shpreh kundër formulës së mazhorancës. Në të njëjtën linjë ishte edhe zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, Ilir Panda.

Më i ashpër në qëndrimin e tij përpara deputetëve ishte kreu i Shoqatës së Gjyqtarëve, Gerd Hoxha. Ai theksoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të negociohet.

Kundër draftit u rreshtua edhe opozita, e cila kërkoi rrëzimin e ndryshimeve dhe kritikoi qeverinë për mënyrën e përcaktimit të pagave në sistemin e drejtësisë.

Nga ana e tyre, shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë kundërshtuar formulën e propozuar nga mazhoranca socialiste për ndryshimin e pagave të magjistratëve, duke argumentuar se rritja e parashikuar nuk përmbush standardin e vendosur nga Gjykata Kushtetuese.

Ata u shprehën se, nëse projektligji miratohet në formën e propozuar, ai do të dërgohet për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

Përplasja për pagat në sistemin e drejtësisë nisi pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik formulën e re të pagave, në përputhje me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese.

Pas përfundimit të afatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosën që, nga 1 gushti, paga referuese të llogaritej mbi 222 mijë e 425 lekë, duke i shtuar edhe 14 mijë lekë për kualifikimin./Versus.al

Poll



POLITIKË

[Protestat në Shqipëri, ambasadori kroat: Shenjë e një demokracie të shëndetshme, pakënaqësitë e qytetarëve të dëgjohej!](#)

15 Shtator 2026, 16:02

^ekstrakti^





POLITIKË

["Përsëri Tirana pa kokë", Rama reagon pas vendimit për Erion Veliajn: Kalvari i kryebashkiakut është unikal në historinë e Europës](#)

15 Shtator 2026, 15:23

^ekstrakti^



POLITIKË

["Mos e bëni kaq të madhe", deputetja e PS ngatërron 'magjistarin' me 'magjistratët': Ishte lapsus](#)

15 Shtator 2026, 13:25

^ekstrakti^



POLITIKË

[Qindra aplikime për rrjetin MIA, Rama: Si ka mundësi kjo dëshirë për të punuar me propagandën e 'regjimit'?](#)

15 Shtator 2026, 09:48

^ekstrakti^



POLITIKË

[Hapet Konsullata e Nderit në Napoli, Rama merr pjesë në ceremoninë e inaugurimit](#)

14 Shtator 2026, 20:47

^ekstrakti^





POLITIKË

Bregdeti i Semanit do të mbushet me parqe foto voltaike? Bashkia Fier hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

14 Shtator 2026, 20:03

^ekstrakti^



POLITIKË

"S'është çështje inati..." , Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson dot Parlamentin!

14 Shtator 2026, 19:31

^ekstrakti^



POLITIKË

Gjyqtarët rritën pagat, Braçe: Të na kërkojnë ndjesë, vendimi i tyre mori kompetencat e Kuvendit

14 Shtator 2026, 16:11

^ekstrakti^

Të fundit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.